

SENAD NEZIRI

**LESIKU BLEGTORAL I SHQIPES NË TË FOLMET MINORITARE
NË REGJIONIN E PRIZRENIT**

1.Hyrje

1.1 Qëllimi dhe metodologjia

Ky punim ka për qëllim evidentimin e leksemave shqipe të fushës së blegtorisë në të folmen sllave në zonat minoritare në regjionin e Prizrenit dhe ndriçimin e faktit që këto leksema kanë prejardhje shqipe ose etimologjikisht i përkasin shqipes, apo përmes shqipes kanë depërtuar në këto të folme. Gjithashtu, kishim për qëllim që, mundësisht, përmes gjuhës dhe pranisë së elementeve të shumta të shqipes, në këtë të folme sllave dhe në zonat e caktuara sllavishtfolëse, ta forcojmë hipotezën tonë që shqipja ose leksemat dhe elementet e ndryshme të shqipes që përdoren në të folmen sllave të kësaj popullate, nuk janë asgjë tjetër, vetëm se një proces trashëgues i cili është përcjellë brez pas brezi nga të parët e tyre, të cilët, pak kohë para Luftës së Dytë Botërore ishin shqiptarë, gjë e cila dëshmohet me veshje dhe rite të ndryshme të cilët, përpos gjuhës, këto nuk i kanë humbur.

Për ta realizuar këtë punim, kemi bërë një hulumtim gjatë vitit 2014. Ndërkaq sa i përket metodologjisë së mbledhjes së materialit kemi bërë incizime të shumta të bisedave të rastit, por në disa raste kemi pasur synime të caktuara, siç janë rastet e bisedave me pleq dhe tregimet e përrallave ose bisedave të ndryshme me to. Të gjitha këto mostra i kemi ruajtur në kompjuter dhe i kemi transkriptuar në letër. Përpos incizimit të rasteve, ku kemi krijuar mostra studimi, kemi bërë edhe anketime përmes një pyetësoi në të cilin kemi përdorur mostrat e rastit, por në disa raste, edhe këtu si të incizimi, siç janë personat e identifikuar si shumëgjuhësh, kanë qenë grupe të synuara. Edhe të anketuarit kanë qenë kryesisht popullsi aktive, në kuptim të angazhimit të tyre në studime dhe vendet e profesionet e tyre të punës, pastaj kishim të anketuar edhe amviset dhe personat familjarë. Hulumtimi është kryer në komunën e Prizrenit, përkatësisht në zonat minoritare të Grykës së Lumbardhit (Zhupës) dhe zonave tjera ku i kemi evidentuar vatrat e të folmeve joshqipe, ndërsa hulumtimin nuk e kemi zgjeruar jashtë territorit të komunës së Prizrenit.

Në këtë hulumtim të opinionit publik, që të jemi më objektiv, nga të anketuarit kemi marrë informata për përkatësinë etnike, gjuhën amtare, profesionin, gjininë, prejardhjen regjionale (në këtë rast nënkuptohet zona minoritare brenda komunës së Prizrenit) dhe vendbanimin. Respondentëve ua kemi sqaruar se anketimi bëhet për qëllime studimore dhe që informatat e marra prej tyre do të përdoren vetëm në kuadër të këtij studimi dhe do të mbeten e drejtë e autorit të studimit, meqë e dëshmon edhe fakti që respondentëve u është dhënë

mundësia të mbeten anonimë, pa e dhënë emrin e tyre, por duke u mjaftuar me të dhënat tjera, pra jemi munduar që gjatë anketimit t'i respektojmë kriteret etike të punës në terren. Gjatë hartimit të pyetësorit kemi përdorur kryesisht pyetjet me përgjigje të hapura, ku e kemi kërkuar mendimin e lirë dhe origjinal të çdo respondentit, ndërsa pyetësorët kanë qenë të përgatitur me shkrim. Ndërsa, sa i përket bisedave, kemi zhvilluar bisedat e lira ose kemi kërkuar nga respondentët të na tregojnë nga një ngjarje ose përrallë.

Gjatë hulumtimit tonë kemi hasur edhe në vështirësi të shumta gjatë mbledhjes së materialit hulumtues. E para dhe e përgjithshme, ishte frika e respondentëve që të japin informata, të incizohen ose ta plotësojnë ndonjë pyetësor, për këtë arsye kemi rastet ku nuk janë plotësuar emrat në pyetësorë ose nuk na është lejuar t'i referohemi vendit të incizimit.

2. Leksiku blegtoral i shqipes në të folmet e minoriteteve – njohuri të përgjithshme

Nga puna jonë kemi vërejtur që leksiku është pjesa më qëndrueshme e gjuhës dhe ai depërton shumë lehtë në një gjuhë tjetër. Kështu edhe këto dialektet e të folmeve sllave jugore në rrethin e Prizrenit kanë huazuar nga leksiku i shqipes një numër të konsiderueshëm të fjalëve, ose siç thamë, këtë dukuri të pranishme së leksemave ose elementeve të shumta të shqipes në të folmen e tyre e kanë trashëguar.

Leksikologjia ka një fushë studimi mjaft të gjerë, të rëndësishme dhe të vështirë, ndoshta për këtë ndikimi i leksikut të shqipes ndeshet më shumë nëpër gjuhë të tjera, në këtë rast në të folmet e dialekteve sllave jugore në rrethin e Prizrenit, se sa ndeshet pjesa morfologjike. Një punë të tillë e pati filluar gjuhëtari Ivan Popović (1957), i cili, siç ka pohuar vetë, kishte mbledhur rreth 500-600 albanizma në serbokroatishte, maqedonishte e bullgarishte, por shumica e tyre nuk janë botuar për shkak të vdekjes së parakohshme të autorit. Më pas vijën punimet e Ajetit, Çabejt, Blakut, Ismajlit, Omarit, Muratit e shumë gjuhëtarë të tjerë, tek të cilët jemi bazuar në etimologjitë shqipe të fjalëve të gjetura në këto të folme sllave. Por, mbi të gjitha gjuhëtari ynë prof. Çabej (SGj, IV, 1987:342) kur flet për kontributin e shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike, për ndikimin leksikor të shqipes në gjuhët sllave jugore, vëren se ndikimi i shqipes, ashtu si në greqishten e re, edhe në gjuhët sllave jugore serbokroatisht e bullgarisht përfshin më fort sferën materiale se mendoren, në radhë të parë, jetën baritore dhe blegtarinë, jetën shtëpiake dhe shtazët shtëpiake, emra shtazësh e bimësh, sidomos emra drurësh.

Shumica prej huazimeve leksikore përdoren ndonjëherë me një ndryshim nga përdorimi i shqipes, por baza e ndikimit është po ajo fjalë shqipe, që nënkuptohet se ndikimi ka ndodhur në këto të folme në një kohë shumë më të vjetër se që mund të mendojmë. Këto fjalë të gurrës shqipe, ne i kemi gjetur në përdorim të përditshëm nga popullata sllavishtfolëse e zonave minoritare të Prizrenit, por edhe janë trajtuar e dëshmuar nga gjuhëtarë që i përmendëm më lart. Huazimet e këtilla gjuhësore, që flasin për një ndikim të theksuar të shqipes në këto dialekte sllave jugore të përdorura në rrethin e Prizrenit edhe përtej rrafshit leksikor, mund të

shpjegohen para së gjithash me faktorin e bilinguizmit ose edhe të multilinguizmit të shkallës më të lartë. Por, çka është më interesante dhe më e rëndësishme për shqipen si gjuhë dhënëse, këto leksema përdoren nga një popullatë e cila në ditën e sodit deklarohet si popullatë boshnjake, gorane, torbeshe, nashke, por edhe serbe. Gjuhët e Ballkanit përgjithësisht edhe në frazeologjinë e tyre kanë krijuar një aftësi tipologjike që dikur se kanë pasur, prandaj edhe në frazeologji ka aftësi të mëdha, sidomos ka shumë frazeologji turke ose modele ballkanike me fjalë turke, gjë që na e vështirëson identifikimin e sidomos klasifikimin e tyre se cilit popull e cilës gjuhe i përkasin.

2.1 Leksemat blegtoriale

baljga = **balgë** fjalë e cila përdoret në pjesët rurale në territorin e të folmeve sllave jugore në rrethin e Prizrenit me trajtat *baljega*, *baljgae*, por edhe *bagla*. Ajetit (SGjFSh, III, 1985:295) i evidenton dy trajtat e para, gjithashtu edhe Omari (1989/1:52) i evidenton trajtën *balega* për të folmet jugore të serbishtes, dhe që të dy, Ajeti dhe Omari, përfundojnë se këto trajta vijnë nga fjala shqipe *balgë*, *bagëlë*, njëjtë sikur që e sjell Skoku (I, 1971:100). Në Dragash, sidomos në fshatin Brod, kemi vërejtur se fjala *baljaga*, *baljega* përdoren me të madhe, por edhe vetë *bagla* përpunohet dhe përgatitet si lëndë djegëse për dimër.

baljoš = **balo** fjalë e hasur në gjithë territorin e të folmeve sllave jugore në rrethin e Prizrenit, e që përdoret për emërtimin e kafshëve, si: *Da vrzem baljeta u koljiba* (shq. Na lidhi balon¹ në stelë). Kjo fjalë evidentohet si *baljoš* nga Ajeti (SGjFSh, III, 1985:295) nga shqipja *balo*, Zymberi (1996:23) e gjen me trajtën *balo* (Anamali) për qenin me *balë* në *ballë* dhe *bala* për *dhinë* me *balë* në *ballë*, ndërsa Popović (SOF XV, f. 515-520) fjalën *baljoš* e gjen në leksikun e Bosnjë e Hercegovinës, ku këto lidhje V. Čorović² i sheh si lidhje të vjetra shqiptare-boshnjake-hercegovinase. Të pranishme në të folmen e goranëve të regjionit të Prizrenit e regjistron Idrizi (2012:307) dhe e sqaron si ndikim nga shqipja. Cena (VII – 1977/1978:325) i regjistron shembujt me fjalën *balo*, *Balja ima baljku na čelo* (shq. Baba ka një balushë në ballë), *Njegov baloš je dembelj* (shq. Kali i tij Balosh është përtac), *Moja baljuša se bucala* (shq. balusha ime rrafëj me shoqe). Në të njëjtat vija shkon edhe emri i lopës *Kuqesha* (Kučeša) që vjen nga shqipja i kuq, siç vijnë emërtimet Kuqjan etj.

bardž = **bardhë** këtë fjalë më shumë e kemi hasur në pjesët rurale ose në vendet ku gjendet bagëtia p.sh. *Bardzava ovca*. Omari (1989/1:52) e evidenton trajtën *brdoka* për delen e bardhë dhe këtë trajtë e sjell nga fjala shqipe *bardhokë*, ose edhe Cimochowski (2004:330) skr. **barzast** ‘i përhimtë’ (khs. bullg. **barzav** ‘i përhimtë’) nga shq. **bardhë**, Skoku (I, 1971:115) fjalën **barzast** e sjell nga shqipja. G. Elezovići (1932:31) e regjistron patronimin Bardiq, me të cilin i njeh pjesëtarë të barkut të Bardiqve, patronim i cili për bazë e ka rrënjën *i bardhë* të

¹ Fjala është për qenin, por ky emërtim përdoret edhe për viqin, kaun, dashin dhe lopën (baluša).

² V. Čorović, *Napomena e albanskim tragovima u Hercegovini*, “Arhiv za arbanašku starinu” I, f. 202-203.

shqipes dhe po me këtë rrënjë i gjejmë te G. Elezoviçi (1932:59) edhe fjalët që përdoren në shumë pjesë të të folmeve sllave të Ballkanit, *brdoka* e *Bardhoka*. Zymberi (1996:24) e gjen trajtën *bardhane* në Anamali të Malit të Zi, por e jep edhe etimologjinë e fjalës *Baca (dele me turinj krejt të bardhë)*, për të cilën thotë se vjen nga rrënjori i shqipes *bardh*. Në kuptim të kësaj fjale Rexhepagiq (I – 1971/1972:155) e regjistron emrin për llojin e deleve më të mira *bardoka* nga shqipja *bardhokë*. Si Patronim Bardovci e kemi regjistruar në fshatin ganofolës Leshtane të Gorës (Dragash) dhe se ky patronim nga Idrizi (2012:308) konsiderohet si i shqipes.

brina = **brin** fjalë e hasur pjesërisht në gjithë zonën sllavishtfolëse të Prizrenit. Me të njëjtin kuptim si *vend thikë*, *buzë* e jep Ajetit (SGjFSh, III, 1985:295), por i evidenton edhe emërtimet e dy katundeve në mes Tivarit e të Ulqinit me emrin *Brinje* (Ajeti, 1968/2:37), por edhe Omari (1989/1:53) e sqaron njëjtë dhe e jep për vendin e Dalmacisë si vend bregdetar nga shq. *brinjë*. Kastrati (2000:31) kur flet për historinë e albanologjisë fjalën *brin* e radhit në mes të fjalëve ilire. Disa kuptime të fjalëve, si: *Uzdignuta zemlja*, *brdo*, *Zemlja kraj jarka* etj. Skoku (I, 1971:211) i lidh me fjalën shqipe **brina**.

cjap = **cjapi** duke u bazuar në Çabejn (SGj, IX, 1989:51-53), Ajetin (GjA, 1968/2), Hoxhën (1984/2:38) dhe me një rezervë edhe në Skokun (I, 1971:251), dhe në argumentet e gjetura në terren edhe fjalën *cjap* e cila përdoret deri-diku në të folmet sllave të Prizrenit e marrim si ndikim i shqipes. Gjithashtu edhe formën e thirrorit kur e drejtojmë tufën e dhive cap-cap mund ta marrim si formim nga kjo fjalë. Gjithashtu e kemi hasur edhe fjalën *kec*, por edhe *p'rç* për cjapin nga shqipja *përç*, njëjtë sikur që e sqaron Omari (1989/1:53) për të folmet jugore të serbishtes dhe Ajeti (GjA, 1968/2:42). Doçi (1990/b) fjalën e shqipes cap-i e gjen tek emërtimi i katundit Caparci, e cila fjalë si patronim ose toponim është zgjeruar me prapashitesën -ar.

fundrina = **fundrinë** hera-herës fjalën e kemi hasur në gjithë zonën e të folmeve sllave jugore të rrethit të Prizrenit, por si karakteristikë e personave të moshuar dhe nëpër zonat rurale, p.sh.: *ostanala u kofa skros taja fundrina* (shq. në kovë ka mbetur e gjithë ajo fundrinë). Cena (VII – 1977/1978:328) e regjistron si fjalë shqipe në të folmet sllave të Rahovecit.

djiza = **gjizë** fjalën e kemi hasur në çdo pjesë të të folmeve sllave jugore në rrethin e Prizrenit për një lloj bulmeti ose për qumësht të zënë. Kjo fjalë përdoret paralelisht me fjalën *urdë* (shih leksemën *urdë*), p.sh. *Prodado jeno deset kila djiza* (shq. *Shita nja dhjetë kilogram gjizë*) etj. Këtë fjalë Shapkarevi (sip. Muratit, 1990:42) për të folmet e maqedonishtes e shënon me trajtën *xhizd*, por pa dhënë shpjegime rreth kuptimit të fjalës. Pastaj Selishçevi (sip. Muratit, 1990:42) për të folmet e Pollogut e gjen trajtën *dzira*. Kuptimin e këtyre trajtave mund ta lidhim me fjalën shqipe *xhizë*, *gjizë*, edhe pse ndoshta një latinizëm, pasi që te Jokli (1911/2011:52) gjejmë shënime se kjo fjalë është hasur në Shkodër, në fjalorin e Bashkimit, te Rossi, por e shtjellon edhe Çabej (SGj, I, 1986:228-229) etj.

namuren = **i murrinë**, **i murgët** fjalë që përdoren në gjithë zonën e të folmeve sllave jugore në Rrethin e Prizrenit e që i kemi hasur shprehjet: *Ka si se*

namurila ko cel svet da je na tebe. Prava si **murda**. A od čat i sert avaa i d'n ič na čev i **namuren** (Adžo, 2006:120). Omari (1989/1:52) në të folmet jugore të serbishtes për kaun me qime bojëkafe e gjen trajtën *muronja* e që e sjell nga shqipja *murrë*, i *murrme*. Zymberi (1996:104) e gjen trajtën murgshëm për vranët, vrenjtur për motin në Krajë.

pamuk = **pambuk** fjala si pambuk e diku si pamuk përdoret në gjithë zonën e të folmeve sllave jugore të rrethit të Prizrenit, p.sh.: *Uzi malo pambuk/pamuk za posekotine* (shq. Merr pak pambuk për varrë) etj. Fjalën si të ardhur nga shqipja e ka shpjeguar Ismajli (1987:170) nga fjala *pambuk*.

šilježe = **sheleg** fjalë e hasur në zonat rurale të rrethit të Prizrenit p.sh. *Imam nekoljiko šilježe jagnca*. Omari (1989/1:53) për të folmet jugore të serbishtes e gjen trajtën *šiljeg* për *qingj* nga shqipja *sheleg*, ndërsa Zymberi (1996:140) për qengjin mashkull prej gjashtë muajsh e tutje në Triesh të Malit të Zi e gjen trajtën *shiéz*, në Kodër të Budanit *shiérz* e për qengjin femër *shiéze/ja* në Kojë të Malit të Zi.

škuma = **shkumba** në hulumtimet tona në gjithë zonën e rrethit të Prizrenit i kemi gjetur disa fjali me fjalët *shkumosa*, *se isshkumavila*, të cilat mund t'i lidhim me fjalën shqipe *shkumba* ose edhe kur flasim për rakinë e cilësisë së mirë, siç gjen Nesimi (1986/2:23), *čkumba rakija*, ose siç e jep Omari (1989/1:53) *škumba* nga shq. *shkumbë*, por edhe Ismajli (1987:170) *škuma* nga shqipja *shkumbë*.

šuta = **shytë** fjalë e hasur më shumë në zonat rurale sesa në zonën urbane të Prizrenit p.sh. *Šuta koza pa se buca*. Gjithashtu edhe Omari (1989/1:53) e dallon si huazim nga shqipja për të folmet jugore të serbishtes nga shqipja *shut*, *shyt*. Këtë fjalë (shyt) Zymberi (1996:152) e gjen për *Kaun me brirë të vegjël*. Majeri (1891: 487) fjalën e konsideron si të shqipes.

štaljba = **shtalb** fjalë që e kemi hasur në pjesë të kufizuara rurale të zonës së rrethit të Prizrenit për të emërtuar një gjellë prej ajke, djathi a qepësh që Omari (1989/1:53) e bien nga fjala shqipe *shtalb*, *shtalp*, gjithashtu Cimochowski (2004:330) e sqaron me prejardhje shqipe skr. **štaľba** 'gjellë prej ajke, djathi e qepe' nga shq. *shtalb*.

trlo, tërlo, tor = **torishte** nga hulumtimet e bëra në terren e kemi hasur edhe fjalën *trlo*, *tërlo*, por vetëm dy-tri herë e kemi hasur trajtën *tor*, e cila është karakteristike për të folmet sllave të maqedonishtes, ndërsa dy të parat e para për serbokroatishten dhe e dyta për bullgarishten. Pas analizës së përdorimit të këtyre fjalëve kemi konstatuar se janë ndikime të drejtpërdrejta të shqipes *torishte*, pasi që në gjuhët sllave të përmendura për këtë fjalë ekzistojnë fjalët adekuate *mandro* e *stan*, por kemi *Na torishte (tërlo e trlo) mi sa ovce*. Këto sqarime i jep Hoxha (1984/2:46).

ugič = **ugič, ogič** fjalën e kemi hasur në pjesën më të madhe të të folmeve sllave jugore të rrethit të Prizrenit, kryesisht në zonat rurale dhe këtë fjalë e marrim të shqipes duke u bazuar në shpjegimin e E. Çabejt (SGj III, 1987:73), P. Skokut (ERHSJ III, 537), O. J. Nasteva (Lek. Balk., 220), Omarit (1989/1:53), Ismajlit (1987:170), Zymberit (1996:165) etj., e jo siç del e trajtuar te disa fjalorë të serbokroatishtes (RSHKJ 6, 409) e shqipes (FFH, Prishtinë, 1988, f. 634) si një

huazim prej turqishtes) ose edhe te Xhelal Ylli (2012:538). Trajta e gjetur në zonën e Prizrenit është *Kakaf si ka ugič* (shq. Çfarë je si ugiç >i paqethur<).

urda = urdë, hurdhë fjalën e kemi hasur në çdo pjesë të të folmeve sllave jugore në rrethin e Prizrenit për një lloj bulmeti ose për qumësht të zënë. Kjo fjalë përdoret paralelisht me fjalën *gjizë* (shih leksemën *gjizë*), p.sh. *Prodado jeno deset kila urda* (shq. Shita një dhjetë kilogram **urdë**) etj. Kjo fjalë ka edhe një përhapje të madhe në gjuhët ballkanike. Këtë fakt e dëshmon Skoku në Fjalorin e tij (III, 546), Jokli (1911/2011:54), Ismajli (2012:11), pastaj Murati (1990:42) në kuadër të gjuhëve sllave e gjen për maqedonishten me trajtën *urda* dhe e sqaron nga shqipja *urdë, hurdhë*, por i citon edhe gjuhëtarë të tjerë që e kanë hasur këtë fjalë, si Mejerin (1891: 204), Barçin, Paskun etj.

zek'r, czech'r = xekër fjalë e evidentuar në zonat rurale të zonës së Prizrenit njëjtë sikur te shqipfolësit ashtu edhe te sllavishtfolësit. Më së shumti e kemi gjetur të përdorur me trajtën dialektore, ku theksohet fonema x njëjtë si në shqipen, *xek'r*, sesa me trajtat *zek'r, czech'r* etj.³ Këtë e kemi gjetur në shprehjen go ufati *xekër/xekar* (shq. e kapi zekthi), ndërsa në shqipen dialektore të Kosovës *xekër-zekth*. Si fjalë e shqipes e evidenton Omari (1989/1:52).

BIBLIOGRAFI

- A. Omari (1989). *Ndikime të gjuhës shqipe në të folmet jugore të serbishtes*, në “Studime filologjike”, 1, ASHRPSSH, IGjL, Tiranë, f. 43-61.
- A. Zymberi (1996). *Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi*, IAP, Prishtinë.
- E. Çabej (1986). *Studime gjuhësore*, I, Rilindja, Prishtinë.
- E. Çabej (1987). *Studime gjuhësore*, III, Rilindja, Prishtinë.
- E. Çabej (1987). *Studime gjuhësore*, IV, Rilindja, Prishtinë.
- E. Çabej (1989). *Studime gjuhësore*, IX, Rilindja, Prishtinë.
- G. Elezović (1932). *Rečnik kosovsko-metohijskog dijalekta*, I, Beograd.
- G. Meyer (1891). *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Botimet Çabej, 2007.
- I. Ajeti (1968/2). *Studimet leksikore shqiptare-sllave*, “Gjurmime albanologjike”, IAP, Prishtinë.
- I. Ajeti (1985). *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*, III, Rilindja, Prishtinë.
- I. Popović (1957). *Elementet e gjuhës shqipe në gjuhë të tjera*, “Përparimi”, 1-2.
- J. Kastrati (2000). *Historia e albanologjisë (1497-1997), në vëllimin I (1497-1853)*, Tiranë.
- J. Rexhepagiq (1972). *Disa elemente të gjuhës shqipe në të folmen e popullsisë së Plavës*, në “Gjurmime albanologjike”, Seria e shkencave filologjike, I-1971, IAP, Prishtinë, f. 151-157.
- N. Jokli (1911). *Studie zur albanesischen Etimologie und Wortbildung*, Wien, botuar me përkthim nga ASHAK, 2011, Prishtinë.

³ Më shumë për fonemën X në të folmet sllave jugore të rrethit të Prizrenit shih S. Neziri, *Disa elemente të mundshme fonetiko-fonologjike të shqipes në të folmet e dialekteve sllave jugore në rrethin e Prizrenit*, në “Filologji” 18, f. 155-164, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2011, f. 155.

Leksiku blegtoral i shqipes në të folmet minoritare në regjionin e Prizrenit

- Nasteva dhe të tjerët (1990). *Kontaktet e të folmeve maqedonase me të folmet shqipe*, në “Gjurmime albanologjike”, Seria e shkencave filologjike, 19-1989, Prishtinë, f. 55-63.
- P. Skok (1971). *Etimologjiski rječnik Hrvatskoga ili Srpskoga jezika, I*.
- P. Skok (1973). *Etimologjiski rječnik Hrvatskoga ili Srpskoga jezika, III*.
- Q. Murati (1990). *Elementet e shqipes në gjuhët sllave jugore*, IAP, Prishtinë.
- R. Doçi (1990). *Onomastika shqiptare kosovare para Betejës së Kosovës (1389)*, në “Gjurmime albanologjike”, Seria e shkencave filologjike, 19-1989, f. 169-183, Prishtinë.
- R. Ismajli (1987). *Fjalë shqipe në maqedonishte*, në përmbledhjen Artikuj mbi gjuhën shqipe, Rilindja, Prishtinë.
- R. Ismajli (2012). *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*, Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë nga ASHAK dhe ASHSh, Prishtinë.
- R. Nesimi (1986). *Disa elemente shqipe në të folmet e maqedonishtes perëndimore*, në Gjuha shqipe, 2, IAP, Prishtinë, f. 21-31.
- S. Cena (1978). *Disa elemente të gjuhës shqipe në të folmen e popullsisë së Rahovecit*, në “Gjurmime albanologjike”, Seria e shkencave filologjike, VII-1977, IAP, Prishtinë, f. 321-334.
- S. Hoxha (1984). *Elemente leksikore të shqipes në disa të folme të maqedonishtes*, në Buletin shkencor, 2, ILP, Shkodër, f. 37-46.
- S. Idrizi (2012). *Uticaq albanskog jezika na govor i narodnu poeziju Gore*, në Kumtesat nga Konferenca Vjetore e Shkencës “Java e Shkencës 2012”, MASHT - DShT, Prishtinë.
- S. Neziri (2011). *Disa elemente të mundshme fonetiko-fonologjike të shqipes në të folmet e dialekteve sllave jugore në rrethin e Prizrenit*, në “Filologji” 18, f. 155-164, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
- W. Cimochoowski (2004). *Për gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë.
- Xh. Ylli (2012). *Rreth përgatitjeve për një vlerësim objektiv të huazimeve leksikore sllave të gjuhës shqipe*, Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë nga ASHAK dhe ASHSh, Prishtinë.

